

CIRCLE

PRODUCTION

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR CIRCLE Production SHPK

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1: Data e themelimit, emri dhe themeluesi

Sot, me datë 26 mars 2024, z. Besnik Krapi, në pozicionin e themeluesit, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "CIRCLE Production" SHPK (këtu e më poshtë Shoqëria).

Themeluesi i Shoqërisë është z.Besnik Krapi, atësia Sadik, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me nr 035843195 dhe me numër personal I61103086A, i datëlindjes 03 nëntor 1986, lindur në Shkarashnik, Kosovë dhe banues në Tiranë, Rruga e Dibrës, ndërtesa 64, hyrja 4, Njësia Administrative 8, Njësia Bashkiake nr 8, 1017, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

Neni 2: Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Xhirimi i filmave dhe videofilmave
- Veprimtaritë e organizatave profesionale
- Shfaqja e filmave
- Veprimtaritë e radiotelevizionit
- Krijimet letrare dhe artistike dhe shfaqja e tyre
- Veprimtaritë e tjera zbavitëse, p.c.
- Veprimtaritë e tjera të rekreacionit, p.c.
- Veprimtaritë e tjera afariste, p.c.
- Publiciteti (reklamat dhe propaganda)
- Veprimtari të fotografimit
- Hulumtimi i tregut dhe i opinionit

Neni 3: Kohëzgjatja

- Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4: Selia

- Shoqëria e ka selinë në: Qendra Emerald, Kati 4, Nr.1 Rruga 5 Maji, Tirana 1001
- Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.



CIRCLE

P R O D U C T I O N

KREU II KAPITALI

Neni 5 Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestari shoqërisë është 100 (_njëqind) lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesëmarria e themeluesit në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:
 - a) Ortaku themelues, z. Besnik Kapi, është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 1) Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një auditues ligjor për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 2) Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 3) Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
- 4) Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

- 1) Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
- 2) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 3) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj
- 3) Asambleja e Përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) Për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) Për ndryshimet e statutit;
 - c) Për emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) Për emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) Për përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) Për mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarisë;

Faqe 2 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
CIRCLE Production SHPK



CIRCLE

P R O D U C T I O N

- g) Për miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) Për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) Për pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) Për përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) Për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) Për miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) Për çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 4) Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 5) Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në Asamblenë e Përgjithshme.
- 6) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- 1) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

- 1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 2) Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 3) Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më lart, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 1) Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesh te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 2) Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të Shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të auditëve ligjorë;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve;
 - e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

Faqe 3 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

CIRCLE Production SHPK



CIRCLE

P R O D U C T I O N

- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- 3) Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

- 1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga Shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

- 1) Administratori i Shoqërisë emërohet z. Besnik Krapi, atësia Sadik, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me nr 035843195 dhe me numër personal I61103086A, i datëlindjes 03 nëntor 1986, lindur në Shkarashnik, Kosovë dhe banues në Tiranë, Rruga e Dibrës, ndërtesa 64, hyrja 4, Njësia Administrative 8, Njësia Bashkiake nr 8, 1017, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me afat emërimi 5-vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.
- 2) Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të Shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një Shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 4) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14

Kompetencat e administratorëve

- 1) Administratori/ët ka/në të drejtë e detyrohet/n:
 - a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) të kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) të përgatisin dhe nënshkruajnë pasyrat financiare vjetore (bilancin vjetor), pasqyrat financiare të konsoliduara (bilancin e konsoliduar) dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmajtjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme përmiratim;
 - e) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) të kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmiratim;
 - g) të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë përmiratim;
 - h) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 2) Administratorët janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas pasqyrave financiare vjetore (bilancit vjetor) apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



- b) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- c) Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht Shoqërinë.
- 4) Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me Shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15
Përgjegjësitë e Administratorit

- 1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajtë të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.
- 2) Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht, sipas rastit, pasojat përkatëse.
- 3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, administratori detyrohet:
 - a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjesht;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të Shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 4) Administratori, gjatë kryerjes së detyrateve të tij, përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 5) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbuje Shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrateve të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyrë solidare.
- 6) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbuje Shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet Shoqërisë;
 - d) lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
- 7) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngenë padi penale kundër administratorit.
- 8) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar Shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Faqe 5 e 7

Statut i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

CIRCLE Production SHPK



**KREU IV
VITI FINANCIAR, EKSPERTET**

**Neni 16
Viti Financiar**

- 1) Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt me 31 dhjetor.

**Neni 17
Ekspertët**

- 1) Audit ligjor (eksperti) ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të Shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 2) Ne përfundim të kontrollit auditit ligjor përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të pasqyrave financiare vjetore si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'jua paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve për t'i shqyrta e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

**KREU V
PRISHJA, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 18
Prishja dhe likuidimi**

- 1) Shpërndarje ose prishja e Shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me ligjin.
 - e) me vendim të gjykatës;
- 2) Ne këtë rast ortaku/ët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerrë prej tij/tyre emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".
- 3) Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortaku/ët.
- 5) Nëse ortaku/ët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19
Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja**

- 1) Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**Neni 20
Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe me dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.



CIRCLE
P R O D U C T I O N

**Neni 21
Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
CIRCLE Production SHPK
Besnik KRAPI**

